

## Homelia 5 nëntor 2022

### Kujtimi liturgjik i Martirëve tanë

Është një frazë e famshme e Gustav Mahlerit që mbyll itinerarin e vizitës në Muzeun tonë Dioqezan; ajo thotë se traditat nuk përdoren për të adhuruar hirin, por për të mbajtur zjarrin ndezur. E njëjta gjë vlen për çdo festë përkujtimore si në sferën fetare, ashtu edhe në atë civile.

Duke kremtuar festën e të Lumëve tanë Vinçenc Prennushi me Shokë Martirë, nuk është qëllimi ynë as që ta përqendrojmë vëmendjen te një e kaluar që tani nuk është më, aq më pak t'i konsiderojmë Martirët tanë si perëndi. Përkundrazi, dëshirojmë që të kuptojmë vlerën e dëshmisë së tyre të jetës dhe të kërkojmë ndërmjetësimin e tyre vëllazëror për ta jetuar mirë të tashmen, në mënyrë që të jemi përgjegjës për të ardhmen tonë.

Fatkeqësisht, kombi ynë po përjeton një kohë në të cilën rrallë ka prej atyre që janë të gatshëm të ekspozohen për të mirën e përbashkët: preferojnë të emigrojnë, duke lënë atdheun në të cilin Zoti i ka bërë të lindin, për të ndjekur mirazhin e një jetë më e mirë gjatë; jetë më e mirë, nga ana tjetër, e cila duhet demonstruar nëse është e tillë.

Është e vërtetë se kushtet në të cilat ndodhet toka jonë nuk janë më të favorshmet për mirëqenien, por është gjithashtu e vërtetë se përgjegjësitë nuk i atribuohen vetëm klasës drejtuese: secili prej nesh është një lloj përgjegjës, secili për pjesën e vet, për të mirën dhe të keqen.

Martirët tanë të Lumë e kishin kuptuar mirë këtë gjë, pasi, përballë mundësisë që shumë prej tyre të largoheshin nga Shqipëria ose të mos ktheheshin ndërsa ishin jashtë shtetit, preferuan t'u qëndronin pranë njerëzve të tyre derisa dhanë jetën. Por nëse nuk duam të ndjekim shembullin e tyre, me çfarë guximi dalim përpara Zotit për të kremtuar festën e tyre? Po ashtu: me çfarë guximi i shfaqim botës shenjat e krenarisë për faktin se i përkasim këtij populli, nëse nuk kemi guxim të luftojmë, duke paguar personalisht, për përmirësimin e kushteve të jetesës?

Historia e Martirëve tanë nuk është një risi absolute. Gjatë gjithë shekullit të kaluar ka pasur shprehje të ngjashme në vende të ndryshme të botës; dhe leximet biblike që dëgjuam në këtë Meshë pak minuta më përpara na tregojnë se që në fillimet e botës “*vëllai vëllanë dhe babai fëmijën do ta dorëzojë në vdekje*” (Mt 10, 21), siç thotë Jezusi në Ungjill. Në leximin e parë, i njëjti fat i martirëve tanë përshkruhet në ngjarjet e vëllezërve të Juda Makabeut dhe Ungjilli na thotë se ky realitet vazhdon të përsëritet në histori sa herë që dikush guxon të përballet me të keqen.

Do të ishte mirë që kjo luftë kundër së keqes të na linte gjallë e shëndosh: fatkeqësisht nuk është kështu, sepse lufta kundër së keqes ka edhe pasoja të dhimbshme. Por mësimi themelor i kësaj Fjale të Zotit sot është i dyfishtë:

- nga njëra anë na jepet arsyeja pse është e nevojshme që të angazhohemi personalisht për ndryshim;
- nga ana tjetër na është dhënë një premtim fitoreje.

Martirët tanë e kuptuan mirë arsyen e luftimit: arsyeja ishte Jezu Krishti Mbret. Jezusi kishte thënë: “*Për shkak timin do t'ju qesin para sundimtarëve e mbretërve*” (Mt 10, 18). Ata që luftojnë për drejtësi, pra ata që luftojnë që e keqja të hiqet dhe e mira të realizohet, luftojnë që të vijë Mbretëria e Hyjit. Edhe në Ungjillin e Lumturive që shpallëm në festën e të gjithë Shenjtërve, kemi dëgjuar: “*Lum ata që salvohen pse kryejnë çka Hyji kërkon, sepse e tyre është Mbretëria e qiejve*” (Mt 5,10). Ja çfarë kuptimi ka shpallja e bukur e fesë në buzët e Martirëve tanë: “*Rroftë Krishti Mbret, rroftë Shqipëria!*”. Jo një patriotizëm bosh, jo një përkatësi sterile ndaj tokës shqiptare, por vetëdija se vetëm duke realizuar drejtësinë, duke bërë atë që është e drejtë dhe vetëm duke realizuar mbretërinë e Krishtit, kjo tokë, atdheu i tyre dhe yni tokësor, do të mund të gjejë paqe.

Por ata e kishin shumë të qartë edhe premtimin e fitores të shpallur nga Jezusi: “*Porse, kush do të qëndrojë deri në fund, ai do të shëlbohet*” (Mt 10, 22). Premtim që e shohim të përmbushur përsosmërisht në ta sipas fjalëve të Shën Gjonit në Librin e Zbulesës: “*Një shumicë e madhe... qëndronte para Qengjit të veshur me petka të bardha... i lanë petkat dhe i pastruan në gjakun e Qengjit*” (Zb 7,9-14).

Toka jonë pati momentin e vet të fitores, siguruar edhe falë sakrificës së Martirëve tanë, me përmbysjen e komunizmit. Sidoqoftë, kjo fitore u pasua nga një kohë që zgjatet edhe sot: një kohë nënshtrimi ndaj një skllavërie të re, më shumë të një lloji kulturor dhe shumë më djallëzore (*si konsumizmi dhe liberalizmi esagjeruar!*), e cila, ndërkohë që të bën të besosh se je një person i lirë, në fakt të çon në logjika shumë larg Zotit.

Është larg Zotit logjika e mirëqenies me çdo kusht dhe menjehershëm, madje edhe me rrugë të shtrembura dhe me padrejtësi.

Është larg Zotit logjika e korrupsionit që fëmijët tanë mësojnë që në shtëpi, duke ndjekur shembuj të këqij dhe më pas në shoqëri.

Është larg Zotit logjika e egoizmit që na çon të interesohemi vetëm për gjërat tona dhe të lëmë pas dore të mirën e përbashkët.

Është larg Zotit logjika që sheh një formim të ulët kulturor-shoqëror të femijve dhe të të rinjve tanë.

Lista do të ishte e gjatë, por preferojmë ta zëvendësojmë atë me litanitë e lutjes drejtuar Martirëve tanë të Lumë, që të gjithë ta kuptojmë rëndësinë e një angazhimi serioz, të motivuar nga dashuria e Krishtit dhe të mbështetur nga shpresa e një ndryshimi serioz, falë kontributit të secilit.

Nuk duhet të kërkojmë që të ndryshojnë vetëm të tjerët apo institucionet: besimi ynë i krishterë na shtyn të rishikojmë veten tonë, mënyrën tonë të jetesës. Duhet të jemi ne ata që ndryshojnë, pa pritur asgjë nga të tjerët. Edhe ne, si Martirët tanë, mund dhe duhet të jemi shembull për pjesën tjetër të popullatës jobesimtare; dhe, si Martirët tanë, lutemi dhe ndërmjetësojmë pranë Zotit për të mirën e popullit tonë.

Prandaj, nëse vërtet dëshirojmë të jemi ndërtues të mbretërisë së Hyjit në këtë tokë, lulëzoftë në gojën tonë thirrja e Martirëve tanë të Lumë: “Rroftë Krishti Mbret, rroftë Shqipëria!”.

Qoftë levduar Jezu Krishti.

+ Angelo Massafra OFM  
Arqipeshkev